



REPUBLIKA E KOSOVËS /
REPUBLIKA KOSOVA / KOSOVA CUMHURIYETI

C.nr.748/12

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, gjyqtari Valon Totaj, me procesmbjatësen Drita Qerreti, në kontestin e paditësit G. L. nga Prizreni, të cilin e përfaqëson i autorizuari i tij av. N. Q. nga Prizreni, kundër të paditurës K. Sh.A. me seli në Prishtinë - Distrikti në Prizren, të cilën e përfaqëson i autorizuari i saj Z. Sh. nga Prishtina, për shkak të anulimit të vendimit dhe kthimit në vend të punës, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, me datën 21.05.2013, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit G. L. nga Prizreni, me anë të së cilës ka kërkuar që “të anulohen vendimet të së paditurës K., me nr..., të datës 18.07.2012, dhe vendimit ...të datës 30.07.2012, me anë të së cilave i është shkëputur marrëdhënia e punës paditësit dhe të obligohet i padituri që paditësin ta kthej në vendin e punës dhe atë specialist i dalje duke i’a njohur të gjitha të drejta nga vendi i punës ku ka punuar deri më shkëputjen e marrëdhënies së punës, t’ia kompensoj të gjitha të ardhurat që nga momenti i shkëputjes së kontratës e deri më datën 31.01.2012, (sipas të ardhurave për vendin e punës në të cilin ishte i sistematizuar paditësi, para se t’i ndërprehet kontrata e punës), me kamat ligjore nga dita e parashtrimit të padisë, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm, si dhe t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës” **si tërësisht e pabazuar.**

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta gjyqësore.

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve

Paditësi G. L. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate përmes të autorizuarit të tij, ka parashtruar padi kundër të paditurës K. Sh.A. me seli në Prishtinë – Distrikti në Prizren (në tekstin e mëtutjeshëm K.), duke cekur se ai ka qenë në marrëdhënie pune tek këtu e paditura në bazë të kontratës së punës nr..., kontratë kjo e cila është ndërprerë me vendimin e të paditurës nr..., të datës 18.07.2012, ndaj të cilit vendim paditësi ka ushtruar ankesë, e cila me vendimin tjetër nr. ..., të datës 30.07.2012, është refuzuar si e pa bazë. Paditësi me anë të padisë po ashtu ka theksuar se në dipozitivin I të vendimit theksohet se punëtorit i shkëputet kontrata e punës për shkak të shkeljeve të rënda të obligimeve të punës, ndërsa në arsyetim nuk përmendet asnjë shkelje e obligimeve të tilla. Po ashtu sipas të autorizuarit të paditësit nuk është ligjore që performanca të llogaritet në mënyrë grupore dhe për mos

arritjen e performancës të një grupi të përjashtohet individi. Kjo nuk duhet të ndodh posaçërisht nëse merret parasysh fakti se paditësi gjatë muajt prill ka pasur performancën prej më shumë se 100%. Ndërsa ishte pikërisht paditësi ai i cili me vendimin e të paditurës është përjashtuar nga puna, për shkak të mos përmbushjes së mjaftueshme të detyrave të punës. Gjykatës i ka propozuar aprovimin e kërkesë padisë si të bazuar në ligj, duke i kërkuar edhe shpenzimet procedurale. Përmes padisë, i autorizuari i paditësit ka kërkuar që të anulohet njoftimi - vendimi i të paditurës - menaxherit të Distriktit të Prizrenit me nr. ..., i datës 18.07.2012, me të cilin është shkëputur kontrata e punës e paditësit G. L. dhe të obligohet e paditura që paditësin G. L., ta kthej në marrëdhënie pune aty ku ka qenë më herët, respektivisht si specialist i daljeve në Distriktin e Prizrenit, si dhe që ta obligoj të paditurën që t'i bartë të gjitha shpenzimet procedurale të shkaktuara pa fajin e paditësit.

Edhe përgjatë shqyrtimeve gjyqësore i autorizuari i paditësit av. N. Q. nga Prizreni, ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë, kërkesëpadisë, parashtresave të dhëna si dhe deklarimeve nga seancat e mëhershme. Ka shtuar se kërkesëpadia e paditësit në tërësi është e vërtetuar si e bazuar dhe një gjë e tillë është vërtetuar me prova të administruara në këtë çështje juridike kontestimore. Ai po ashtu ka deklaruar se paditësi ishte në marrëdhënie pune tek e paditura prej vitit 2006, deri sa e paditura nuk e ka shkëputur këtë marrëdhënie me vendimet kontestuese, anulim i të cilit kërkohet në këtë çështje dhe atë për shkak se nuk ka arritur performancën e caktuar në punë. Ai ka shtuar se vendimi i tillë është marr në kundërshtim me dispozita ligjore si të atyre procedurale po ashtu edhe të atyre materiale, e kjo ngase performanca është llogaritur kolektivisht e jo individualisht. Sipas tij, paditësi jo që i ka realizuar objektivat e punës, por ai ato edhe i ka tejkaluar, duke realizuar një punë prej 91% të punës për të cilën ishte i obliguar, duke realizuar performancën më të mirë individuale në grupin e tij. I autorizuari i paditësit ka vazhduar duke theksuar se edhe me dëgjimin e dëshmitarëve në këtë çështje kontestimore, është vërtetuar jo ligjshmëria e vendimeve të të paditurës, përkatësisht e paditura e ka llogaritur performancën grupore e jo individuale, duke i diskriminuar punëtorët, diskriminim ky i ndaluar me nenin 5 të ligjit të punës. Ai po ashtu ka theksuar se me dëgjimin e drejtorit të të paditurës, në cilësinë e dëshmitarit, është vërtetuar se paditësi ishte punëtor i dalluar, se asnjëherë nuk ka bërë shkelje të obligimeve të punës dhe se paditësi i është lejuar të punoj prej muajit prillit e deri në muajin korrik, muaj këta ku ai ka treguar performancë të kënaqshme, dhe se marra e vendimit për shkëputje të kontratës pas 3 muajve tregon qartë shkeljet ligjore nga ana e të paditurës me rastin e ndërprerjes së kontratës së punës të paditësit. Vendimi i sulmuar është në kundërshtim me memorandumun nr..., të datës 13.01.2013 të të paditurës, prandaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykatës i ka propozuar që ta aprovoj kërkesëpadinë si të bazuar, t'i anuloj vendimet e sulmuara të të paditurës, në mënyrë që punëtori të kthehet në vendin e punës, si dhe që e paditura t'ia kompensoj të ardhurat personale sipas kontratës së punës, që nga shkëputja e kontratës e deri më datën 31.12.2012, t'ia njuh të gjitha të drejtat e tjera nga vendi i punës, duke i kërkuar shpenzimet procedurale në shumë prej 695 euro, krejt këto në nën kërcënimin e përmbartimit të dhunshëm pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

E paditura K., përmes të autorizuarit të saj, në përgjigjen me shkrim ndaj padisë së paditësit ka deklaruar se e konteston në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit me arsyetimin se kontrata e punës atij i'u ka shkëputur me fajin e tij. E paditura ka vepruar në harmoni me ligjin kur paditësi i është shkëputur kontrata e punës me njoftimin për shkëputjen e kontratës së punës nr..., të datës 18.07.2012, të cilit më parë i ka shqiptuar vërejtje me shkrim dhe vërejtje të fundit me shkrim për shkak të mos përmbushjes së performances, përkatësisht për shkak se nuk e ka përmirësuar performancën edhe pas paralajmërimeve të mëhershme. E paditura i'a ka ndërprënë kontratën e punës pasi që paditësi edhe pas vërejtjeve me shkrim nga ana e të paditurës, edhe në muajin prill të vitit 2012, nuk e ka arritur performancën e kërkuar nga ana e të paditurës, performance kjo e

përcaktuar me Kodin e Distrikteve përkatësisht me nenin 8 paragrafi 8.2 të tij, duke cekur më tutje se ndërprerja e kontratës ka ndodhur në bazë të Kodit Disiplinor të të paditurës, kur ndërprerja bëhet vetëm me njoftim, nga çka kuptohet se e paditura ka vepruar drejt kur paditësit i'a ka shkëputur kontratën e punës, pasi që i njëjti nuk i ka përmbushur obligimet të dala nga vendi i punës në të cilin ka punuar. Në bazë të të lartëcekurave, i autorizuari i të paditurës gjykatës i ka propozuar refuzimin e kërkesëpadisë së paditësit si të pa bazuar në ligj.

Edhe përgjatë shqyrtimit kryesor i autorizuari i të paditurës Z. Sh. nga Prishtina, ka theksuar se mbetet në tërësi pranë përgjegjës me shkrim ndaj padisë së paditësit. Ka shtuar se nga provat e administruara është vërtetuar se vendimet e të paditurës me anë të së cilës i është ndërprerë kontrata e punës këtu paditësit, janë të bazuara në dispozitat ligjore dhe aktet normative të së paditurës. Kjo edhe duke marr parasysh se paditësi për muajin prill të vitit 2012, nuk ka arritur performancën e nevojshme të përcaktuar me norma të brendshme të së paditurës dhe se kjo nuk është hera e parë, ngase për këtë çështje këtu paditësit i është tërhequr vërejtje edhe më herët dhe atë së pari i është shqiptuar vërejtje me shkrim dhe herën e dytë i është shqiptuar vërejtje e fundit me shkrim, njëherit duke i'u është tërhequr vërejtja se nëse rezultati i pakënaqësëm i punës përsëritet, atëherë do të pasoj shkëputja e kontratës. Ai po ashtu ka theksuar se pavarësisht shkaqeve të shkëputjes së kontratës së punës së paditësit, kërkesa e tij për kthimin në punë është jo lëndore nga fakti se palët ndërgjyqëse midis veti kanë lidhur kontratë në kohë të caktuar dhe atë prej 01.01.2012, deri më 31.12.2012, kur edhe i ka skaduar kontrata e punës, prandaj me vetë këtë fakt, atij i ka pushuar marrëdhënia e punës. Sipas tij, nga të lartcekurat shihet se e paditura me të drejt i'a ka shkëputur kontratën e punës paditësit. Përfundimisht, gjykatës i ka propozuar që ta refuzoj kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjendja faktike e vërtetuar

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat si në vijim: vendimin e të paditurës me nr..., të datës 18.07.2012; vendimin e të paditurës me nr..., të datës 30.07.2012, bashkë me tabelat përcjellëse; kartelën e punëtorit për paditësin G. M. L. me nr. të ID ..., të datës 26.07.2012; vërejtjen me shkrim të të paditurës me nr..., të datës 25.05.2011; vendimin e të paditurës nr., të datës 13.02.2012; është bërë dëgjim i dëshmitarëve B. N. dhe V. S.; si dhe është lexuar dhe vlerësuar performanca individuale për paditësin G. L. për muajin shkurt, mars dhe prill të vitit 2011 dhe 2012.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartëcekura, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se:

Kërkespadia e paditësit ËSHTË E PA BAZUAR.

Nga leximi e vendimit të së paditurës me nr... të datës 18.07.2012, gjykata ka vërtetuar faktin se këtu paditësit G. L., i caktuar në detyrat e punës specialist i daljeve në Distriktin e Prizrenit, nga data 18.07.2012, e paditura K. i'a ka shkëputur kontratën e punës dhe atë për shkak se nuk ka arritur performancën e paraparë sipas normave të brendshme të të paditurës për muajin prill të vitit 2012, më saktësisht sikurse në këtë vendim.

Nga leximi i vendimit të së paditurës me nr..., të datës 30.07.2012, bashkë me tabelat përcjellëse, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes këtij vendimi, është refuzuar si i pa bazuar kundërshtimi i këtu paditësit G. L. i datës 20.07.2012, i parashtruar kundër vendimit

të Menaxherit të Distriktit të Prizrenit, me nr. 1230/1, të datës 18.07.2012, me të cilën paditësit i është shkëputur kontrata e punës, më saktësisht sikurse në këtë vendim.

Nga leximi i kartelës së punëtorit për paditësin G. M. L. me nr. të ID..., të datës 26.07.2012, gjykata ka konstatuar kohëzgjatjen dhe historinë në pikat të shkurta të marrëdhënies së punës të paditësit, tek e paditura, dhe atë duke filluar prej themelimit të marrëdhënies së punës, e deri më 31.12.2012, më saktësisht sikurse në këtë kartelë.

Nga leximi i vërejtjes me shkrim të të paditurës me nr..., të datës 25.05.2011, gjykata ka vërtetuar faktin se këtu paditësit i është shqiptuar vërejtja me shkrim për shkak të mos përmbushjes së objektivave të punës, apo për performancën e dobët me rastin e pastrimit të bazës së shënimeve për disa konsumator, parregullsi këto të dala nga auditimi në muajin prill të vitit 2011, më saktësisht sikurse në këtë vendim.

Nga leximi i vendimit të të paditurës nr..., të datës 13.02.2012, gjykata ka vërtetuar faktin se këtu paditësit G. L., i është shqiptuar vërejtja e dytë me shkrim, përkatësisht vërejtje e fundit me shkrim, nga ana e të paditurës, për shkak të mos përmbushjes së performancës dhe atë për tre muaj: nëntor, dhjetor të vitit 2011, dhe janar të vitit 2012, performancë kjo të paraparë me neni 8 paragrafi 8.2 të kodit të distrikteve, më saktësisht sikurse në këtë vendim.

Për vërtetimin sa më të drejtë të gjendjes faktike, gjykata ka bërë dëgjimin e dëshmitarit B. N. nga Prizreni, i lindur më 25.06.1975, në Prizren, i cili është punëtori i të paditurës, tek e cila punon si elektrikistë i rrjetit, i cili ka deklaruar se ai nuk ka të bëjë me llogaritjen e performancës, ndërsa sa është ai në dijeni në momentin e largimit nga puna të këtu paditësit janë larguar edhe disa punëtor tjerë si, N. K. dhe M. K.. Dëshmitari po ashtu ka deklaruar se secili specialist i daljeve i ka daljet dhe shigjetat e caktuara dhe se këtu paditësi G., për aq sa ka dijeni dëshmitari ka qenë përgjegjës për dy dalje dhe atë për dalje të "Rahovecit dhe të "Podrumit".

Në anën tjetër, dëshmitari V. S. i lindur më 20.08.1966 në fshatin K., Komuna e Dragashit, tani me banim në Prizren, i cili është edhe Drejtori i distriktit në Prizren, në dëshminë e tij ka deklaruar se llogaritja e performancës bëhet sipas rregullores r.4, që është në fuqi, performancën të cilën e bëjnë koordinatori ose personi përgjegjës i distriktit, apo nën distriktit. Ai ka vazhduar se në muajin prill të vitit 2012 linja 0 sipas rregullores së përmendur performanca e caktuar ishte 83%, ndërsa performanca e grupit, pjesë e të cilit ishte edhe paditësi kanë arritur 58.16% , apo nëse e llogaritim atë në tre muajt atëherë ajo (performanca) ishte 56.58%, që donë të thonë se grupi ishte larg prej performancës së kërkuar. Dëshmitari ka vazhduar se pas propozimit të koordinatorit të nën distriktit, që kundër këtij grupi të mirët masë, ne kemi theksuar se grupi duhet të jetë më vigjilent, ndërsa ata edhe pas tre muajve të tërë nuk kanë arritur performancën e duhur. Për këtë shkelje sipas normave të së paditurës, mund të shqiptohen dy masa disiplinore dhe atë vërejtje me shkrim dhe vërejtja e fundit me shkrim, pas të cilëve jepet vendimi për shkëputjen e kontratës së punës. Sa i përket kriterit të llogaritjes së performancës, dëshmitari ka deklaruar se kriteri për këtë është inkasimi me energjinë në disponim për shitje si dhe normës ditore sipas zonës me numër të shkyçjeve, ngase nëse punëtori sipas detyrave të punës me urdhëresa për punën ditore realizon normën e shkyçjes për zonën realizon 25 shkyçje me urdhëresa, në zonën e dytë 20 shkyçje me urdhëresa dhe në zonën e tretë 15 shkyçje me urdhëresa, dhe i prezanton me argumente të proceduara dhe të plotësuar, atëherë punëtori konsiderohet se e ka kryer punën e vet në mënyrë të rregullt, gjë të cilën nuk e ka bërë grupi i përmendur, ka shpjeguar dëshmitari. Dëshmitarit ka shtuar se llogaritja e performancës bëhet si për individ ashtu edhe për grup, dhe se po ta kishte

plotësuar normën e tij këtu paditësi atëherë sigurisht se kundër tij nuk do të ishte ndërrmarr masa disiplinore. Dëshmitari po ashtu ka deklaruar se llogaritja e performancës së punëtorit bëhet sipas gjithë energjisë që është në disponim për shitje, apo energji e cila dërgohet tek konsumatori, pra ai është i ngarkuar edhe me humbjen e energjisë, që do të thotë se punëtori është i obliguar të blloboj pikat të cilat konsumatori mund të keqpërdorë, ndërsa sa i përket performancës së parashtruar për paditësin me nr. rendor 8 dhe 9, të shkresave të lëndës, humbjet e energjisë për muajin prill kanë qenë 21.62%, ndërsa për tre mujorin kanë qenë 24.77%, dhe se objektivi prej 88% i cekur në kolonën 14 do të thotë arritje e objektivave sipas inkasimit në raport me energjinë elektrike me disponim për shitje gjë për të cilën punëtori me bonus. Dëshmitari ka shtuar se çdo punëtor ka për detyrë ditore të realizoj shkyçje sipas urdhëresave. Dhe se sikur paditësi të kishte ofruar shkyçje të realizuara me procesverbale të plotësuar mirë, sigurisht se nuk do të kishte ardh deri te masa disiplinore. Përqindja e shkyçjeve duhet të jetë 100%, e jo 97% apo 98%, ku nuk llogaritet evitimi i shkyçjeve (kur në momentin e shkyçjes konsumator tregon fletëpagesën për borxhin që e ka paguar), ka shpjeguar dëshmitari duke theksuar se të gjitha masat disiplinore dhe bonuset janë të bazuara në norma juridike të së paditurës. Dëshmitari për fund theksoj se gjatë sezonit dimëror punëtori duhet të arrij objektin prej 5% më tepër se të njëjtin muaj vitit paraprak, apo në tre mujorin 5%, më tepër se vitin e kaluar, në raport me inkasimin.

Nga leximi i performancës individuale për paditësin G. L. për muajin shkurt, mars dhe prill të vitit 2011 dhe 2012, gjykata ka konstatuar faktin se këtu paditësi në muajin shkurt të vitit 2011, ka arritur performancën prej 79.62%, për muajin mars të të njëjtit vit ka arritur 78.69% dhe për muajin prill të vitit të njëjtë ka arritur 54.72% ku mesatarja e tre mujorit është 68.00%, ndërsa për të njëjtin muaj të vitit 2012, ka arritur performancën prej 59.07% (shkurt), 64.69% (mars), 57.68% (prill), apo një mesatare për tre muaj ishte 60.06%. me vërejtje në fund ku theksohet se në performancë duhet llogaritur edhe humbjet komerciale e që janë për tre muajit të vitit 2011 në përqindje prej 26.32%, ndërsa për tre mujorin e vitit 2012, janë 34.26%.

Baza ligjore

Sipas nenit 70 para. 1 nënpar.1.6 të Ligjit të Punës të Republikës së Kosovës nr.03/L-2121, është e paraparë se *“punëdhënësi mund t’ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit pa periudhën e kërkuar të paralajmërimit atëherë kur: i punësuarit është fajtor për përsëritjen e një keq sjelljeje më pak serioze ose të shkeljes së detyrimeve, apo kur performance e të punësuarit mbetet e pakënaqshme përkundër paralajmërimit me shkrim”*. Me nenin 70 par.1 të po këtij ligji është paraparë se *“punëdhënësi mund ta ndërpresë kontratën e punës në bazë të nënparagrafit 1.6 të par.1 të këtij neni, vetëm atëherë kur i punësuarit ka marrë përshkrimin në formë të shkruar të performances së pakëndshme, në një afat të përcaktuar kohorë brenda të cilit i punësuarit duhet ta përmirësoj përormancën e vet, si dhe një deklaratë se dështimi për përmirësimin e performances do të rezultojë me largim nga puna pa asnjë paralajmërim të mëtejme me shkrim”*.

Vlerësimi përfundimtarë i gjykatës

Nga provat e administruara dhe dispozitave ligjore gjykata ka vlerësuar se padia e paditësit është pa bazuar, e kjo para se gjithash se paditësi nuk ka prezantuar asnjë provë të besueshme se vendimi i të paditurës me anë të së cilës i është ndërprerë marrëdhënia e punës paditësit janë të kundërligjshme. Ligji i procedurës kontestimore, parasheh se barra e të provuarit bije mbi paditësin, pra i njëjti ishte i obliguar që gjatë shqyrtimit të kësaj

çështje ti ofroj prova gjykatës për besueshmërinë e kërkesëpadiës, gjë të cilën paditësi nuk e ka bërë.

E paditura me vendimin kontestues i ka ndërprerë paditësit kontratën e punës për shkak të mos përmbushjes së objektivave të punës, apo performancës së dobët. Nga shkresat e lëndës del përfundim se e paditura me vendimin ... të datës 25.05.2011, këtu paditësit për shkak të mos përmbushjes së performancës, i ka shqiptuar masën disiplinore *vërejtje me shkrim*. Për kundër kësaj mase paditësi prapë vazhdon me mos përmbushjen e objektivave të punës, dhe atë për muajin nëntor dhe dhjetor të vitit 2011, dhe të janarit të vitit 2012, ku si pasoj e mos përmbushjes i është shqiptuar masa disiplinore *vërejtja e dytë me shkrim*, e cila i është shqiptuar paditësi me vendimin nr... të datës 13.02.2012, dhe se pas kësaj paditësi e përsërit performancën e dobët të tij dhe si rezultat me vendimin i cili është objekt i këtij kontesti i është ndërprerë kontrata e punës. Bazuar në bazën ligjore të theksuar më lartë, vendimet e së paditurës me anë të së cilës i është ndërprerë marrëdhënia e punës janë të bazuar ligjërisht. E kjo pasi që i padituri disa herë (edhe pse i është tërhequr vërejtja, me vendimet të cekura më lartë) nuk ka arritur performancën e paraparë për vendin e punës së tij (nëntor dhe dhjetor të vitit 2011 dhe janar të vitit 2012, si dhe maj i vitit 2011), dhe si rezultat i saj e paditura merr vendim për shkëputjen e kontratës së punës.

E paditura përveç performancës grupore gjykatës i ka ofruar edhe performancën individuale të këtu paditësit prej të cilës qartë shihet se i njëjti nuk ka përmbushur performancën mujore të tij dhe se duke i marr parasysh dy vërejtje të më hershme të shqiptuara për të njëjtën çështje, atëherë e paditura merr vendimin për shkëputjen e kontratës së punës, gjë të cilën e ka bërë në përputhshmëri të plotë me norma ligjore në fuqi. Dëshmi kjo të cilës gjykata ia fali besimin e plotë.

Paditësi me kërkesëpadinë ka kërkuar edhe kthimin në vendin e punës dhe kompensimin e të gjitha të ardhurave që dalin nga vendi i punës Specialist i daljeve në të cilin paditësi ka punuar deri më shkëputjen e kontratës së punës nga ana e të paditurës, por gjykatës nuk i ka dorëzuar asnjë kontratë të punës, të lidhur midis tij dhe të paditurës. Pra në mungesën e provave për bazueshmëri të kërkesëpadiës gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me dëgjimin e dëshmitarit V. S. gjykata ka vërtetuar se performanca e punëtorëve bëhet si në mënyrë grupore po ashtu edhe të saj individuale, ku i njëjti ka bërë edhe shpjegimin se si bëhet llogaritja e performancës tek e paditura, dëshmi kjo të cilës gjykata ia fal besimin e plotë.

Nga dëshmia e dëshmitarit B. N. gjykata ka konstatuar faktin se përveç të paditësit, për shkak të mos përmbushjes së performancës janë larguar nga puna edhe disa punëtorë të së paditurës, jo vetëm këtu paditësi (ky fakt bije ndesh me pretendimet e palës paditëse se vetë ai është ndëshkuar për jo arritjen e performancës). Kësaj dëshmie gjykata ia falë besimin vetëm në këtë pjesë, pasi që pjesa tjetër e dëshmisë nuk ka pas ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Kontestimet e të autorizuarit të paditësit, të dhëna përgjatë seancave gjyqësore, gjykata nuk i mori për bazë ngase të njëjtat bien ndesh me gjendjen faktike të vërtetuar.

Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet dhe provat e tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është nxjerr konform nenit 450 të LPK-së, për shkak se pala e paditur nuk ka kërkuar shpenzimet gjyqësore.

Nga te lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e konform nenit 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C.nr.748/12, datë 21.05.2013

Procesmbjatesja,
Drita Qerreti

Gjyqtari,
Valon Totaj

KESHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 dite pas ditës së pranimit të të njejtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.